



Programi i punës praktike

Të nderuar studentë, ftoheni të aplikoni në programin e punës praktike në bashkëpunim me projektin e Misionit të USAID-it REPOWER-KOSOVO

* * *

E organizuar nga: Zyra për Zhvillim Akademik - Qendra për Zhvillim të Karrierës – ZZhA / QZhK – Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina “ dhe REPOWER-KOSOVO / USAID

Misioni i QZhK-së, është t’u ofrojë studentëve mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit, ndërmjetësimit më punëdhënësin, hartimit të dokumentëve profesionale në fushën e karrierës dhe udhëzimit në karrierë. Përfituesit e shërbimeve të QZHK-së janë: studentët dhe të diplomuarit e UP-së, nxënësit e shkollave të mesme të cilët kërkojnë mundësi studimi në Universitetin e Prishtinës, fakultetet, organizatat dhe punëdhënësit. Qëllimi kryesor i Qendrës për Zhvillim të Karrierës është përgatitja e studentëve dhe të diplomuarve për tregun e punës përmes këshillimit dhe trajnimeve si dhe informimi i tyre për mundësi të ndryshme të zhvillimit në karrierë.

REPOWER-KOSOVO / USAID - Është projekt i USAID-it , i cili ofronë ndihmë teknike novatore në zgjidhje dhe zhvillim të kapaciteteve që përforcojnë përfundimisht qëndrueshmërinë e sektorit energjetik të Kosovës. Përpjekjet e projektit REPOWER janë të fokusuar tek reforma e sektorit, rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtërishme të energjisë në sistem, si dhe në ndihmën për institucionet lokale me mekanizma të zhvillimit të kapaciteteve. Këto veprime janë inkurajim në zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm ekonomik.

PUNË PRAKTIKE NË KEK, KOSTT dhe ZRrE

Afati i aplikimit: **15 QERSHOR 2017** deri me **30 QERSHOR 2017**

E hapur për studentët e Univeristetit “Hasan Prishtina” për fakultetet si në vijim:

- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), **8** studentë që vijojnë **studimet në nivelin master** në këto drejtime:
 - Elektroenergjetikë Industriale
 - Sistemet Elektroenergjetike
 - Elektronikë apo Automatikë.
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM), **4** studentë që vijojnë **studimet në nivelin master** në këto drejtime:
 - Termoenergjetikë dhe Termoteknikë
 - Mekatronikë
 - Burime të Ripërtërishme

- Fakulteti Juridik, 1 student që vijon **studimet në nivelin master**.

Kriteret për konkurim:

Në këtë konkurs kanë të drejtë konkurrimi të gjithë studentët që i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë studentë të **niveleit master të studimeve**;
2. Nota mesatare duhet të jetë **mbi tetë (8)** për studentët e FIEK dhe FIM, kurse **mbi nëntë (9)** për kandidatin nga Fakulteti Juridik;
3. Njohja e gjuhës angleze

Të gjithë të kualifikuarit që i plotësojnë kriteret e lartpërmendura do të intervistohen nga paneli intervistues që do të jetë në përbërje nga përfaqësuesit e KEK-ut, KOSTT-it, ZRrE-së dhe REPOWER. Për të vlerësuar nivelin e njohjes së gjuhës angleze, një pjesë e intervistës do të zhvillohet në këtë gjuhë.

I gjithë procesi do të administrohet dhe monitorohet nga Qendra për Zhvillim të Karrierës në kuadër të UP-së.

Puna praktike është **me pagesë**.

Studentët e përzgjedhur për punë praktike në KEK, KOSTT dhe ZRrE do të paguhen nga projekti REPOWER përmes UP-së. Secili student do të nënshkruaj kontratë për këtë angazhim me UP-në. Puna praktike pritet të fillojë me **1 SHTATOR 2017** dhe zgjatë **gjashtë (6) muaj**.

Detyrat dhe përgjegjësitë për praktikantë

Përkrahja për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (KOSTT)

Ndihma për Operatorin e Tregut (5 inxhinierë/e të sektorit të energjisë)

Praktikanti/ja do të ofrojë përkrahje për “Operatorin Përgjegjës” si dhe “Operatorin” në aktivitete ditore sipas përshkrimit të punës, gjë që përfshin si në vijim:

- Përkrahja për sigurimin e operimit të tregut sipas Rregullave të Tregut;

Përkrahja për nominimin e programeve kontraktuale për të gjitha palët në tregun e energjisë elektrike.

- Pranimi i informatave nga konsumatorët për parashikimet nga Operatori i Sistemit, si dhe programet e kompensimit për ditën vijuese, por edhe për realizimin e programit ditor.
- Pranimi i nominimeve kontraktuale nga palët në tregun e energjisë elektrike për ditën vijuese.
- Dërgimi tek programi i prodhimit afatshkurtër në sektor, tek konsumi dhe këmbimi në interkoneksion për arsye të analizimit të realizimit fizik.
- Pranimi i informatave nga OS për realizimin e programit të nominuar.
- Shqyrtimi i përputhshmërisë së nominimeve kontraktuale ndërmjet pjesëmarrësve, si dhe kërkimi nga palët që të rregullojnë nominimet e tyre në rast të mospërputhjes
- Shqyrtimi nëse programet e këmbimit ndërkombëtar janë të harmonizuara, si dhe harmonizimi i tyre me OST-të fqinje.
- Dërgimi i të dhënave të harmonizuara tek subjekti koordinues në hierarki.
- Pranimi i informatave nga subjekti më i lartë në hierarki për përputhshmërinë e programeve ndërkufitare.
- Njoftimi i palëve në treg për miratimin e programeve të tyre, si dhe për ndryshimet e mundshme si rezultat i mospërputhjeve
- Dorëzimi i programit final të miratuar tek Qendra e Shpërndarjes (Dispeçingut).
- Dërgimi i raportit të programit të miratuar tek ZRRE-ja dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Përkrahja për alokimin e kapaciteteve interkonektuese

- Pranimi i informatave nga OS për kapacitetet ndërkufitare në kufijtë e KOSTT-it dhe OST-ve fqinje, si dhe publikimi në faqen e KOSTT-it të kapaciteteve të transmisionit në dispozicion për ankande vjetore, mujore dhe ditore.
- Mirëmbajtja e regjistrit të palëve me të drejtë pjesëmarrjeje në ankandet e kapaciteteve ndërkufitare.
- Organizimi i ankandeve vjetore, mujore dhe ditore sipas nevojës për alokimin e kapaciteteve bartëse në kufijtë e KOSTT-it, në pajtim me marrëveshjet bilaterale me OST-të fqinje
- Informimi i Operatorit të Sistemit për rezultatet e ankandit dhe palëve që kanë fituar të drejtat e transmisionit fizik.
- Këmbimi i informatave me OST-të fqinje për palët që kanë fituar të drejtat e transmisionit fizik në kufijtë ndërmjet tyre.

Përkrahja për ankandet e Operimit të Tregut

- Pranimi i ofertave për shitje dhe ofertave për blerje të energjisë elektrike në kushte të tregut të organizuar
- Informimi i pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike dhe i Operatorit të Sistemit të Transmisionit mbi rezultatet e ankandit të tregut të organizuar dhe për informata të tjera për tregun

Përkrahja për organizimin e balancës së tregut të energjisë elektrike për ex-ante

Mbledhja e ofertave, përpilimi i listës së operatorëve ekonomikë prioritarë, si dhe përcjellja e tyre tek operatori i sistemit.

Mbështetje në fusha të tjera për Departamentin e Operatorit të Tregut.

Përkrahja për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) Sh.A.

Ndihma për Divizionin e Qymyrit (2 Inxhinier/e elektronike/automatike/mekatronike)

- Pjesëmarrja në eliminimin e avarive që ngjajnë gjatë operimit me pajisje të ndryshme elektronike që kontrollohen nga PLC ,
- Ndihma me konfigurimin e PC-ve industriale, instalimet e programeve për PLC (AAB, Siemens), Operatorin e Panelit, LAN, WLAN, dhe të tjera.
- Pjesëmarrja në leximin dhe trajtimin e skemave për qarqe të ndryshme elektronike, si dhe në rregullimin e tyre.
- Pjesëmarrja në eliminimin e avarive që ngjajnë gjatë operimit me pajisje të ndryshme elektrike/elektronike, si konvertori i frekuencave, pllaka e frenimit, rezistori, peshoret elektronike, e të tjera.
- Ndihma në proceset e instalimit dhe parametrizimit – konfigurimi i atyre pajisjeve, si dhe të tjera.
- Pjesëmarrja në përgatitjen e raporteve të nevojave të mirëmbajtjes javore, mujore dhe vjetore për ato pajisje.
- Pjesëmarrja në leximin dhe trajtimin e skemave për qarqe të ndryshme elektrike, si dhe në rregullimin e tyre,

Ndihma për Divizionin e Gjenerimit – TC Kosova A (2 Inxhinier/e energjie/mekanike)

- Ndihma për Departamentin e Elektikës/Mekanikës në punët e përditshme, në ekzekutimin e punimeve të ndryshme të nevojshme në asetet kryesore të centralit;
- Ndihma në ndërmarrjen e aktiviteteve dhe masave preventive;
- Ndihma për inxhinierin kryesor në detyrat e tij/saj të përditshme;
- Përkrahja për personelin kryesor në përgatitjen e planeve për remonte;

- Përkrahja për personelin kryesor në përgatitjen e nevojave për investime;
- Përkrahja për procese teknologjike, me anë të skemave teknologjike;

Ndihma për Divizionin e Gjennerimit – TC Kosova B (2 Inxhinier/e energjie/mekanike)

- Ndihma për Departamentin e Elekrikës/Mekanikës në punët e përditshme, në ekzekutimin e punimeve të ndryshme të nevojshme në asetet kryesore të centralit;
- Ndihma në ndërmarrjen e aktiviteteve dhe masave preventive;
- Ndihma për inxhinierin kryesor në detyrat e tij/saj të përditshme;
- Përkrahja për personelin kryesor në përgatitjen e planeve për remonte;
- Përkrahja për personelin kryesor në përgatitjen e nevojave për investime;
- Përkrahja për procese teknologjike, me anë të skemave teknologjike

Përkrahja për Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRR)

Asistencë për Departamentin e Burimeve të Ripërtëritshme (1 Inxhinier/e energjie/mekanike)

- Ndihmon në analizimin e aplikacioneve për Burime të Ripërtëritshme (BRE);
- Ndihmon në analizimin e të dhënave të dorëzuara nga aplikuesit për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga BRE-të;
- Merrë pjesë në vizitat në teren të projekteve që janë në vijim për të cilat ZRR ka lëshuar autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga BRE-të.
- Ndihmon në përgatitjen e raporteve nga terreni për të gjeturat;
- Ndihmon në kontrollimin e respektimit të afateve kohore për aplikuesit që kanë marrë autorizim preliminar apo autorizim final;
- Ndihmon në grumbullimin e të dhënave për teknologjitë e reja për BRE-të;
- Ndihmon në grumbullimin e informatave statistikore për tregjet e energjisë të BRE-ve.
- Ndihmon në përgatitjen e analizave dhe raporteve të cilat delegohen nga departamenti;
- Ndihmon departamentet tjera sipas kërkesave nga këto departamente;

Asistencë për Departamentin Ligjor dhe të Licencimit (1 Jurist nga fakulteti Juridik)

- Ndihmon në përgatitjen e akteve legale që përgatiten nga departamenti ligjor;
- Ndihmon në analizen e aplikacioneve për licencim dhe për autorizim;
- Ndihmon në kontrollimin e dokumenteve të pranuar nga të licencuarit;
- Ndihmon në monitorimin e aktiviteteve të licencuara
- Ndihmon në rishikimin e kornizës ligjore dhe rregullative dhe pajtueshmërinë me Paketën e Tretë të KE;
- Ndihmon zyren e administratës në përgatitjen e raporteve.
- Ndihmon departamentet tjera sipas nevojës.

Informata rreth kriterëve të aplikimit:

Procesi i angazhimit të praktikantëve përmes projektit REPOWER ofron mundësi të barabarta për të gjithë. Në anën tjetër, edhe Qeveria e Kosovës përmes ligjit kundër diskriminimit (Neni 2, Paragrafi b) është e përkushtuar për parime të përfaqësimit të ndershëm për të gjithë personat dhe gjithë anëtarët e komuniteteve gjatë punësimit në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet.

Si të aplikoni?

Afati i fundit për aplikim është **30 QERSHOR 2017**. Aplikantët duhet të dorëzojnë **CV, LM dhe Certifikatën e notave,(në Gjuhen Shqipe)**, në formatin elektronik pdf, në email adresën: gzhk@uni-pr.edu

Kandidatët e përzgjedhur do të thirren për një intervistë në ZZHA – QZHK, për datën dhe orën do të informoheni përmes emailit.